



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 01.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.06.2025 të parashtruar nga operatori ekonomik FINART SH.P.K nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Përkthimi i kodeve ndërkombëtare të diagnozave mjekësore ICD”** me nr. prokurimi **206-25-3623-2-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik FINART SH.P.K e datës 18.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Përkthimi i kodeve ndërkombëtare të diagnozave mjekësore ICD”** me nr. prokurimi **206-25-3623-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 17.06.2025, të publikuar në platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 17.06.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori ekonomik FINART SH.P.K me datën 18.06.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Përkthimi i kodeve ndërkombëtare të diagnozave mjekësore ICD”** me nr. prokurimi **206-25-3623-2-2-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 01.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku theksohet parimi i trajtimit të barabartë

Pretendimet ankimore

Ne si FINART SH.P.K i drejtohem MINISTRISË SE SHENDETËSISË përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim në lidhje me vendimin tuaj për eliminimin tonë dhe shpalljen fitues të një operatori tjetër ekonomik, me çmim më të lartë se ne, përkundër faktit se oferta jonë ishte më e ulët dhe plotësisht e përgjegjshme.

Sipas arsyetimit tuaj, vendimi për eliminimin tonë është mbështetur në pretendimet se:

- Nuk kemi ofruar dëshmi për lektorin e gjuhës serbe;
- Mungojnë kontratat apo marrëveshjet për përkthyesit;
- Nuk kemi ofruar dëshmi për përkthyesin mjekësor;
- Mungon referenca për përvojën e përkthyesit Serbisht–Anglisht, z. Emin Neziraj.

Lidhur me këto pretendime, ju sqarojmë si më poshtë:

1. Të gjitha këto janë dokumente plotësuese, të cilat sipas nenit 59, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, duhet të kërkojnë nga autoriteti kontraktues në rast të mungesës, pa u penalizuar operatori ekonomik në mënyrë automatike.

"Autoriteti kontraktues kërkon sqarime nga OE për përmbajtjen e ofertës ose dokumente plotësuese për të eliminuar paqartësitë."

2. Ne kemi dorëzuar listën e stafit të angazhuar, përmes së cilës ju si autoritet kontraktues do të duhet të kërkonit dokumentacionin përkatës për secilin nga ta, ashtu siç e parasheh edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 001/2021 për Dosjen Standarde të Tenderit.

3. Sa i përket pretendimeve individuale:

o Lektor i gjuhës serbe është z. Ibish Hulaj, siç figuron në listën e stafit. Me këtë kërkesë do të bashkëngjiten dokumentet përkatëse që dëshmojnë kualifikimin dhe përvojën e tij.

o Kontratat dhe marrëveshjet me përkthyesit për këtë projekt janë të nënshkruara dhe bashkëngjiten si dëshmi ligjore e kapaciteteve tona për realizim.

o Për përvojën në përkthime mjekësore, kemi znj. Dunya Domaniku, e cila ka përvojë të dëshmuar dhe për të bashkëngjisim referencë zyrtare si prove, si dhe dokumentacioni për z. Arbnor Ademaj, të dy me përvojë të dëshmuar në përkthime mjekësore.

o Z. Emin Neziraj, edhe pse posedon kontratë me Universitetin e Pejës dhe certifikata të tjera që dëshmojnë përvojën e tij si përkthyes Serbisht–Anglisht, për të shmangur çdo paqartësi, në vend të tij kemi angazhuar znj. Anisa Muric, për të cilën bashkëngjisim dokumentet mbështetëse.

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku theksohet parimi i trajtimit të barabartë, konsiderojmë se refuzimi ynë pa u kërkuar sqarime dhe dokumente plotësuese, përbën shkelje të drejtës sonë për konkurrencë të barabartë.

Gjithashtu, përzgjedhja e një OE fitues me çmim më të lartë, bie ndesh me nenin 61, paragrafi 1, i cili përcakton që autoriteti kontraktues duhet të përzgjedhë ofertën më të favorshme ekonomikisht, nëse përmbush kriteret teknike dhe administrative.

Përfundim:

Duke marrë parasysh që oferta jonë ka qenë më e lirë se ajo e operatorit ekonomik fitues dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore, kërkojmë që të rishqyrtohet vendimi për eliminimin tonë, në mënyrë që të shmangët çdo padrejtësi dhe shkelje e parimeve të konkurrencës së drejtë dhe barazisë.

Gjithashtu, refuzimi pa kërkuar dokumentet plotësuese përbën shkelje të nenit 7 (Parimet Themelore) dhe nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku theksohet obligimi për trajtim të drejtë dhe të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë, si dhe garantimi i efikasitetit dhe transparencës në procedura.

Në pritje të një rishqyrtimi të drejtë dhe objektiv, ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Humbja e të ardhurave të planifikuara - Kompania ka bërë një plan financiar bazuar në ofertën e dorëzuar, duke llogaritur të ardhura që do të siguronin likuiditet dhe stabilitet për një periudhë të caktuar.

Shpenzimet e stafit të angazhuar enkas për këtë projekt- Janë përzgjedhur dhe angazhuar përkthyes profesionistë, lektorë, dhe bashkëpunëtorë teknikë, për të cilët janë bërë shpenzime paraprake në marrëveshje, trajnime apo përgatitje të dokumentacionit.

Kosto administrative dhe ligjore për përgatitjen e ofertës- Janë shpenzuar kohë dhe resurse njerëzore për hartimin e dokumentacionit të tenderit, përkthimin dhe sigurimin e referencave, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet Ankimore të OE ankues:

E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për Rishqyrtim dhe me gjithë vullnetin e AK-MSH që të merret parasysh si ankese meqenëse keni ofertuar me çmimin me të lirë, por ne baze të dëshmive dhe fakteve mund të konstatojmë se pretendimet e juaja janë të pa bazuara.

Fillimisht lista e stafit nuk është kërkuar fare si dëshmi në DT, por janë kërkuar: CV, Diploma Universitare; Kualifikimet; Kontratat ose marrëveshjet për projektin; Vërtetimet-referencat mbi përvojën e punës.

Ne kërkesën për Rishqyrtim i keni ofruar edhe disa dëshmi Dokumente Shtese rreth stafit të kërkuar, meqenëse pikërisht për çështjen e stafit ju jeni eliminuar me vendimin e dt. 17.06.2025.

Me kërkesën për rishqyrtim, ju e keni ofruar dëshmitë për lektor të gjuhës Serbe **z. Ibish Hulaj**, për të cilin keni ofruar një letër Konfirmimi dhe diplomën nga fakulteti i shkencave të trafikut në Zagreb, me të cilin z. Ibish Hulaj ka fituar titullin **inxhinier trafiku PTT**, që nuk është në lamine përkatëse, meqenëse në DT është kërkuar që lektori i gjuhës Serbe **duhet të kenë kualifikim universitar në fushën përkatëse**.

Kriteri në DT: **Gjithashtu oe duhet të kenë të angazhuar minimum një (1) lektor për gjuhën shqipe dhe një (1) lektor për gjuhën serbe, të cilët duhet të kenë kualifikim universitar në fushën përkatëse.**

Gjithashtu edhe Referenca e dëshmuar nga N.SH. " Network Cleaning " me emër të biznesit: **Mervete Tolaj Selmanaj B.I.** nuk është bindës për AK, meqenëse kjo përvojë nuk figuron në CV të z. Ibish Hulaj, si dhe kjo kompani në ARBK ka vetëm veprimtari pastrimi.

Aktivitet/et

Kodi	Përshkrimi
8121	Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave

Me kërkesën për rishqyrtim, ju i keni ofruar edhe tete (8) Parakontrata, ndërkohë që ato është dashtë të jene në dosjen tuaj në kohën e ofertimit, meqenëse si të tilla nuk ka ndonjë vërtetësi që ato janë para ofertimit, andaj edhe bien ndesh me nenin 72 paragrafi 3 i LPP-se në të cilin specifikohet se:

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Për çështjen e mungesës së kontratave ose para kontratave, e konfirmojmë arsyen e eliminimit të cekur në Letrën e eliminimit të dt. 17.06.2025 se mungojnë kontratat ose para kontratat edhe për përkthyesit.

Ta keni parasysh se sipas nenit 59.2 dhe 72.3 të LPP-së, sqarimet shtese mund të bëhen vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, **dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.**

Në këtë rast si mund ta verifikojmë nëse këto para kontrata janë punuar para ofertimit e nuk janë punuar më vonë në kohën e ankesës.


Edhe në kërkesën për rishqyrtim ju nuk keni dëshmuar ndonjë Reference mbi përvojën e përkthyesit Serbisht-Anglisht z. Emin Neziraj, siç është kërkuar në DT si dëshmi i veçantë - **Vërtetime-referenca mbi përvojën e punës;**

Në bazë të arsyeve të lartcekura, kërkesa juaj për rishqyrtim refuzohet si e pa bazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit